



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2020

V E N D I M

Nr. _____, Datë ____ / ____ / 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.5, datë 21.01.2020, të K. Z, kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*bindjeve politike*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, K. Z është me profesion gjeolog. Ai shprehet se ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë Albpetrol sh.a që nga data 16.08.1980, pa shkëputje për 38 vite. Për rreth 15 vite ka punuar si Kryegjeolog, në periudha të ndryshme kohore: 1992-1994 në Qendrën e Prodhimit të Naftës (QPN) Ballsh dhe 2006-2018 në Qendrën e Prodhimit të Naftës (QPN) Patos. Gjatë

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

marrëdhëniet e tij të punës nuk ka marrë asnjë masë disiplinore në ushtrimin e detyrës. Së fundmi, ankuesi ka ushtruar detyrën e Kryegeologut në QPN Fier.

Subjekti ankues, shprehet se problematika e tij fillon që në datën 01.09.2018 kur është kthyer nga leja e zakonshme. Ai vijon duke shpjeguar se, në këtë datë i është komunikuar verbalisht nga ana e Kryeinxhinierit të Qendrës se ai nuk mund të punonjë më në pozicionin e Kryegeologut pasi tani ka kaluar në pozicionin e Specialistit Gjeolog. Lidhur me situatën e krijuar, K. Z nëpërmjet shkresës me nr.9130 prot., datë 24.09.2018 i është drejtuar Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a duke e informuar se, nga data 01.09.2018 e në vazhdim ishte penguar nga ana e Drejtorit dhe Kryeinxhinierit të QPN Fier në ushtrimin normal të detyrës si Kryegeolog. Ai ka pritur reagimin nga ana e Shoqërisë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare. Në mungesë të reagimit të Shoqërisë, z.Z shprehet se, nëpërmjet shkresës me nr.9637 prot., datë 04.10.2018 me lëndë “Kërkesë”, i është drejtuar përsëri Administratorit të Shoqërisë duke e informuar për ngjarjen dhe i ka kërkuar t’i komunikohet zyrtarisht lidhur me vazhdimin e detyrës së tij si Kryegeolog. Në shkresë ankuesi ka bërë me dije se nuk ishte i detyruar të zbatonte urdhëra dhe udhëzime të Punëdhënësit apo vartësve të tij, të cilat ndryshonin kushtet e kontratës së punës. Ai citon se gjatë kësaj periudhë ka shkuar në punë dhe ka qëndruar në zyrën e tij, atë të Kryegeologut, në pritje të konfirmimit zyrtar të pozicionit të tij të punës, pasi shkresërisht nuk kishte marrë asnjë njoftim të tillë.

K. Z citon se, me datë 17.10.2018 është vënë në dijeni të ndryshimit të pozicionit të tij të punës (referuar listë-pagesës së muajit shtator 2018) në të cilën rezultonte se ishte paguar në pozicionin Specialist Gjeolog, me pagë 68.000 mijë lekë dhe se në vend të tij ishte emëruar z.B. Sh.

Ndodhur në këto kushte, kur atij i kanë ndryshuar në mënyrë të njëanshme kushtet e kontratës së punës, ankuesi shprehet se, është detyruar t’i drejtohet Administratorit të Shoqërisë, i cili ka dhe tagrin e Punëdhënësit, nëpërmjet shkresës me lëndë: “Refuzim i pozicionit të punës si Specialist Gjeolog”. Në mbyllje të kësaj shkrese, z.Z ka cituar se: “*Refuzoj pozicionin e punës si Specialist Gjeolog dhe e quaj të zgjidhur marrëdhënien e punës me Albpetrol sh.a nga ana e juaj si Punëdhënës dhe për zgjidhjen e konfliktit do t’i drejtohem Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier*”.

Nga aktet bashkëlidhur ankesës konstatohet se ankuesi çështjen në fjalë e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor, e cila rezulton të jetë regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me nr.1453 akti, datë 31.10.2018.

K. Z, për të faktuar shkaqet për të cilat pretendon diskriminimin: “bindjet politike” dhe “gjendjen shëndetësore”, ka depozituar si dokumentacion provues, respektivisht:

- Vërtetim me nr.114 prot., datë 14.01.2019 të Kryetarit të Partisë Demokratike, Dega Fier, nëpërmjet të cilit vërtetohet se K. Z është anëtar i këtij subjekti politik që prej vitit 2013.
- Vërtetim me nr.12 prot., datë 21.01.2020, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr.3 Fier, nëpërmjet të cilit vërtetohet se pacienti K. Z është pacient kronik që mjekohet për diagnozat “Diabet Mellitus” prej vitit 2008 dhe me hipertension arterial prej vitit 2016.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar konstatimin e diskriminimit për shkaqet e pretenduara dhe dëmshpërblim moral.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:

- K. Z është vënë në dijeni të ndryshimit të pozicionit të punës nga Kryegjeolog në Specialist Gjeolog, me datë 17.10.2018 dhe ankuesi ka refuzuar të pranojë pozicionin/detyrën e re, gjë që ia ka bërë të ditur shkresërisht këtë fakt Punëdhënësit, Shoqërisë Albpetrol sh.a. Lidhur me sa sipërcituar, ankuesi ka vlerësuar se kalimi i tij nga pozicioni i Kryegjeologut në atë të Specialistit Gjeolog; është në fakt ndërprerje e kontratës të punës, pasi kanë ndryshuar elementët thelbësore të saj.
- Bazuar në faktin që ai e ka kundërshtuar shkresërisht atë, së pari pranë Punëdhënësit/Albpetrol sh.a. (Referuar shkresës drejtuar Administratorit, ku *inter alia*, shprehet se refuzon pozicionin e punës si Specialist Gjeolog, pasi e quan të zgjidhur marrëdhënien e punës me Albpetrol sh.a dhe se për zgjidhjen e konfliktit do t’i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier.
- Dhe së dyti, e ka kundërshtuar gjyqësisht atë (pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me nr.1453 akti, datë 31.10.2018); do të thotë se ankuesi ka qenë

në dijëni të faktit të diskriminimit që në muajin tetor 2018. Momenti i njoftimit të zgjidhjes së marrëdhënieve financiare me Albpëtol sh.a nuk lidhet me momentin e marrjes dijëni të zgjidhjes së kontratës së punës, për të cilën dhë ka pretenduar diskriminim nga ana e Punëdhënsit.

- Në kontekst të sa më sipër, **ankuesi ka marrë dijëni për zgjidhjen e kontratës/marrëdhënieve të punës** (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), **që në muajin tetor 2018. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 21.01.2020**, pra më vonë se një vit nga marrja dijëni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt*”, ankesa e K. Z, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: ...“*Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës...*”.

Nga ana tjetër, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: ...“*Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34³ të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje*”.

Duke qenë se ankuesi është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁴, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

³ Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

⁴ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Procedura para gjykatës”.

Ndërsa, sa i takon pretendimit të ankuesit për dëmshpërblim, Komisioneri vlerëson se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat e Tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së K. Z, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindjet politike, gjendja shëndetësore